

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 307, Datë 21.11.2025

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË ALPEX SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFAVE TË NEMO PËR VITET 2026 - 2028**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 286, datë 20.12.2024; si dhe të neneve 15 dhe 19 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.11.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve me nr. 2012/2 prot., datë 18.11.2025, “Mbi pranimin pjesërisht të kërkesës së shoqërisë ALPEX (NEMO) për përcaktimin e tarifave të NEMO për vitin 2026, 2027, 2028”,

Konstatoi se:

I - Aspektet Ligjore dhe Procedurale

- Shoqëria ALPEX sh.a., me shkresën nr. 413 prot., datë 20.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2704 prot., datë 22.10.2025, ka paraqitur kërkesën për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut (NEMO) për vitet 2026–2028. Në vijim, me shkresën nr. 413/1 prot., datë 14.11.2025, është paraqitur versioni i rishikuar i aplikimit.
- Kërkesa është depozituar në përputhje me nenin 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe me dispozitat e “Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 286, datë 20.12.2024. Procedura për shqyrtimin e aplikimit në zbatim të neneve 15 dhe 21 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.06.2016, e cila i njeh ERE-s të drejtën për të kërkuar çdo informacion shtesë që konsiderohet i nevojshëm për vlerësimin e aplikimit.
- Me vendimin nr. 293, datë 13.11.2025, bordi i ERE-s ka përcaktuar hyrjen në fuqi të Rregullores CACM deri më 1 korrik 2026, duke bërë që ALPEX sh.a. të vijojë ushtrimin e funksioneve të NEMO-s për përgjatë vitit 2026 mbi kuadrin aktual rregullator. Për pasojë, vlerësimi i tarifave duhet të bazohet ekskluzivisht në metodologjinë nr. 286/2024.

II - Vlerësimi ekonomik dhe teknik i kërkesës

- Në aplikimin e paraqitur, ALPEX sh.a. ka strukturuar dokumentacionin sipas kapitujve të relacionit shoqërues, ku në kapitullin III ka paraqitur transaksionet e energjisë të realizuara për vitin 2024 dhe për 9-mujorin e vitit 2025, duke përfshirë transaksionet në shitje dhe blerje në

zonën e ofertimit të Shqipërisë, në zonën e ofertimit të Kosovës, si edhe transaksionet e bashkimit të tregjeve Shqipëri–Kosovë.

- Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të plotë të volumit, dinamikës dhe strukturës së aktivitetit tregtar të NEMO-s në tregun e organizuar të energjisë elektrike.
- Në kapitullin IV, shoqëria ka paraqitur realizimet e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën 2020–2024, pritshmëritë financiare për vitin 2025 dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme, duke dhënë informacion të detajuar mbi pozicionin financiar të shoqërisë në të dy zonat e ofertimit dhe duke krijuar bazën e vlerësimit të qëndrueshmërisë ekonomiko-financiare të aktivitetit. Ndërkohë, në kapitullin VI shoqëria ka dorëzuar llogaritjet e komponentëve tariforë në përputhje me Metodologjinë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), përfshirë llogaritjen e Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB), kostot e operimit dhe mirëmbajtjes (OPMC), kostot e amortizimit, normën e lejuar të kapitalit të punës (WCLC) dhe kostot e licencës (LICC).
- Shoqëria deklaron se nuk parashikon të ardhura jotarifore, duke u mbështetur në performancën e deritanishme të aktivitetit. Në kapitullin VII paraqiten të ardhurat e parashikuara nga tarifat, ku vlerësohet se për vitin 2026 të ardhurat do të jenë rreth 155,859,075 lekë, ndërsa për vitet 2027–2028 parashikimet janë ndërtuar mbi tarifat ekzistuese dhe strukturën e të ardhurave sipas zonave të ofertimit.
- Nga shqyrtimi paraprak rezulton se, pavarësisht nivelit të detajuar të treguesve financiarë dhe teknikë të paraqitur në kapitujt III, IV, VI dhe VII, shoqëria nuk ka dorëzuar një Plan Formal Investimesh, sikurse përcaktuar në pikën 7.5 të Shtojcës II të Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).
- Gjithashtu, shoqëria nuk ka paraqitur ndarjen kontabël të veprimtarisë së NEMO-s nga veprimtaritë e tjera të ALPEX sh.a., siç kërkohet shprehimisht nga neni 6, pika 2, e Metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 286, datë 20.12.2024, sipas së cilës kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes duhet të përfshijnë vetëm ato kosto të arsyeshme që u atribuohen drejtpërdrejt funksioneve të NEMO-s. Mungesa e ndarjes së plotë kontabël e vështirëson vlerësimin e drejtë të kostove të aktivitetit të rregulluar.
- Evidencat e paraqitura për Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB) nuk diferencojnë asetet e përdorura ekskluzivisht për ofrimin e shërbimeve të NEMO-s nga asetet e përgjithshme të shoqërisë, ndonëse metodologjia parashikon qartë që në RAB duhet të përfshihen vetëm asetet e lidhura drejtpërdrejt me ushtrimin e funksioneve të Operatorit të Emëruar të Tregut.
- Për sa i përket të ardhurave jotarifore, shoqëria deklaron se nuk gjeneron të ardhura të tilla, duke u bazuar në performancën e deritanishme të aktivitetit, gjë që nënkupton se mbulimi i kostove dhe i investimeve të parashikuara do të varet tërësisht nga të ardhurat e gjeneruara nga tarifat e NEMO-s të paraqitura në kapitullin VII.

III. Objekti, fushëveprim dhe përkufizime

- Qëllimi i aplikimit të paraqitur nga shoqëria ALPEX sh.a. është miratimi i Listës së Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) për periudhën trevjeçare 2026–2028, në përputhje me dispozitat e “Metodologjisë për Përcaktimin e Tarifave të Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 286, datë 20.12.2024, dhe duke respektuar parimet rregullatore të kosto-reflektimit, transparencës, proporcionalitetit dhe parashikueshmërisë së tarifave për subjektet pjesëmarrëse në treg. Në këtë kuadër, aplikimi synon të përcaktojë strukturën tarifore,

komponentët tariforë dhe mënyrën e llogaritjes së tyre për shërbimet që ALPEX sh.a. ofron si NEMO në zonën e ofertimit të Shqipërisë dhe në zonën e ofertimit të Kosovës.

- Tarifat e propozuara janë paraqitur të ndara sipas zonave të ofertimit dhe përfshijnë mënyrën e shlyerjes në monedhë vendase për rezidentët dhe në monedhë të huaj (Euro) për jorezidentët, duke reflektuar gjithashtu detyrimin ligjor për aplikimin e TVSH-së sipas legjislacionit fiskal në fuqi. Struktura tarifore dhe parashikimi i të ardhurave janë ndërtuar mbi bazën e volumit të pritshëm të aktiviteteve të tregtimit, të dhënave historike dhe treguesve financiarë të paraqitur në aplikim.
- Megjithatë, vlerësimi përfundimtar i aplikimit kërkon paraqitjen e informacionit plotësues financiar, kontabël dhe teknik, i cili është i domosdoshëm për verifikimin e përputhshmërisë së kostove të deklaruara nga shoqëria me kërkesat e metodologjisë nr. 286/2024 dhe me standardet e kontabilitetit.
- Në këtë kuadër, pavarësisht se aplikimi përmbush kriteret formale për pranimin për shqyrtim, ai kërkon sqarime dhe dokumentacion shtesë që lidhen me: planin formal të investimeve të NEMO-s për vitin 2026; ndarjen e detajuar të kostove të atribuueshme posaçërisht aktivitetit të NEMO-s, të veçuara nga aktivitetet e tjera të ALPEX sh.a.; identifikimin dhe justifikimin e asetëve të përfshira në Bazën e Rregulluar të Asetëve (RAB) duke evidentuar vetëm asetet e lidhura drejtpërdrejt me ofrimin e shërbimeve të NEMO-s; si edhe çdo informacion tjetër mbështetës që do të kërkohej gjatë vijimit të procesit të shqyrtimit.
- Në zbatim të nenit 21, pika 4, të Rregullores nr. 96/2016, ERE ruan të drejtën të kërkojë çdo informacion që konsiderohet i nevojshëm për vendimmarrje.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë Alpex sh.a. për përcaktimin e tarifave të NEMO-s për vitin 2026.
2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë shoqërinë ALPEX sh.a., Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) të Kosovës si dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI